

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.04/18	Data: 16.01.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 40 alinaja 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 22 alineja 1.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenit 12 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, bie këtë:

V E N D I M

- I. **Arlinda Kurtaj**, e caktuar në punët dhe detyrat, Udhëheqëse e Sektorit Administrativ, pranë Drejtoratit për Administratë Komunale, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.
- II. Pushimi, i cekur në pikën I të këtij Vendimi, fillon me: 16.01.2018 e deri më: 16.10.2018
E përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 17.10.2018
- III. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunësës dhe 3 muajt në vijim, paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj e tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunësës civile.

A r s y e t i m

Arlinda Kurtaj, e caktuar në punët dhe detyrat, Udhëheqëse e Sektorit Administrativ pranë Drejtoratit për Administratë Komunale, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 40 alineja 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 22 alineja 1.2 të Ligjit 03/L-147 për pagat e Nëpunësve Civil, nenit 12 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil, femrës punonjëse i takojnë 9 muaj pushim të lehonisë me pagesë dhe 3 muaj të tjerë pa pagesë të cilat mund t'i shfrytëzoj sipas dëshirës.

Punëtorja ka të drejtë që pushimin e lehonisë të përcaktuar në nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafët 2.2. dhe 2.3. të mos e shfrytëzoj, mirëpo është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë mujor të njoftoj : Menaxherin e Personelit, se nuk dëshiron të shfrytëzoj pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 6 muajve.

Punëtorja gjatë periudhës së pushimit të lehonisë të cekur më lartë, 6 muajt e parë i takojnë 70% e të ardhurave personale që do të paguhet nga Institucioni, ndërsa për 3 muaj tjerë të mbetur, pagesa e pagës prej 50% do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e që realizohet përmes MPMS.

Për realizimin e pagës përmes MPMS-së, punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen : **Arlinda Kurtaj**, Menaxheri i Personelit dhe Përgjegjësjë për Paga, meditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki Rugova

	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Nr.Br. 01-07/018	Data: Datum: 18.01.2018	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13. të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, Nr.28/2008), më qellim të formimit të komisionit për vlerësimin e ofertave për aktivitetin "Furnizim me artikuj ushqimor dhe higjenik për nevoja të institucioneve komunale" me numer prokurimi 633017-114-121 dhe nxjerr:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për Vlerësimin e ofertave për aktivitetin: "Furnizim me artikuj ushqimor dhe higjenik për nevoja të institucioneve komunale" me numër prokurimi 633017-114-121 dhe në Komision caktohen:

- 1). Fatmire Rugova, Drejtoresh e QF "Gëzimi Ynë" në Istog, Kryetare Komisioni;
- 2). Sabrije Blakaj, Zyrtare Administrative në QKMF, anëtare;
- 3). Mirjeta Beqiraj, Drejtoresh në QF "Lulet e Jetës", anëtare;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në bazë të kriterit të paraqitur në dosjen e tenderit për aktivitetin "Furnizim me artikuj ushqimor dhe higjenik për nevoja të institucioneve komunale" të bëjë procesverbalin dhe i njëjti të dorëzohet në zyrën e prokurimit për miratim, si dhe do t'i kryejë punët dhe përgjegjësit të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Anëtarët e komisionit dhe Zyra e prokurimit.

4. Me kopje të Vendimit të njoftohen: Anëtarët e Komisionit Zyra e prokurimit, dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.Zyrtarisht-2018	Data: 22.01.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 49 të Ligjit të Punës 03/L-212(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nxjerr:

V E N D I M

1. Verdicta Bajraktaraj, e caktuar në punët dhe detyrat, Infermiere në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc në mbikëqyrje të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.
2. Pushimi, i cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, fillon me: 29.01.2018 e deri më: 29.10.2018, e përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 29.10.2018.
3. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunës nga data 29.01.2018 deri me datën 29.07.2018 dhe 3 muajt në vijim nga data 29.07.2018 deri me datën 29.10.2018 të paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj e tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunës civile.

A r s y e t i m

Verdicta Bajraktaraj, e caktuar në punët dhe detyrat, Infermiere në Shtëpinë e Komunitetit në Gurakoc në mbikëqyrje të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit të Punës 03/L-212(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), punëtores i takojnë 9 muaj pushim të lehonisë me pagesë dhe 3 muaj të tjerë pa pagesë të cilat mund t'i shfrytëzoj sipas dëshirës.

Punëtorja ka të drejtë që pushimin e lehonisë të përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 49 të Ligjit të Punës të mos e shfrytëzoj, mirëpo është e obliguar që më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit gjashtë mujor të njoftoj: Menaxherin e Personelit, se nuk dëshiron të shfrytëzoj pushimin e përcaktuar në kohëzgjatje prej 6 muajve.

Punëtorja gjatë periudhës së pushimit të lehonisë të cekur më lartë, 6 muajt e parë i takojnë 70% e të ardhurave personale që do të paguhet nga Institucioni, ndërsa për 3 muaj tjerë të mbetur, pagesa e pagës prej 50% do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e që realizohet përmes MPMS.

Për realizimin e pagës përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Verdicta Bajraktaraj, Menaxheri i Personelit dhe Përgjegjësjë për Paga, mëditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



Kryetari i Komunës
Haki RIGOVA

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE		 Komuna e Istogut Opština Istok
	01 Nr.26/18	Data: 26.01.2018	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 49 alinaja 1.3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 22 alinaja 1.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat, bie këtë:

V E N D I M

- I. Edona Bujupi Loxha, e caktuar në punët dhe detyrat, Drejtoreshë e Drejtoratit për Administratë Komunale, caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.
- II. Pushimi, i cekur në pikën I të këtij Vendimi, fillon me: 16.01.2018 e deri më: 16.10.2018 E përmendura duhet të lajmërohet në punë me: 17.10.2018
- III. Në 6 muajt e parë të pushimit të lehonisë, paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë të nëpunëses dhe 3 muajt në vijim, paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë si dhe 3 muaj e tjerë, pa pagesë mund të merren me kërkesën e nëpunëses civile.

Arsyetim

Edona Bujupi Loxha, e caktuar në punët dhe detyrat, Drejtoreshë e Drejtoratit për Administratë Komunale, i caktohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 9 muaj.

Në pajtim me nenin 49 alinaja 1.3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 22 alinaja 1.2 të Ligjit 03/L-147 për Pagat, femrës punonjëse i takojnë 9 muaj pushim të lehonisë me pagesë dhe 3 muaj të tjerë pa pagesë të cilat mund t'i shfrytëzoj sipas dëshirës.

Punëtorja ka të drejtë që pushimin e lehonisë të përcaktuar në nenin 49 paragrafi 6 nëse nuk dëshiron ta shfrytëzoj të drejtën në pushim të lehonisë nga paragrafi 4. dhe 5. të këtij neni, duhet ta lajmëroj punëdhënësin më së voni 15 ditë para përfundimit të pushimit, nga paragrafi 3. i këtij neni.

Punëtorja gjatë periudhës së pushimit të lehonisë të cekur më lartë, 6 muajt e parë i takojnë 70% e të ardhurave personale që do të paguhet nga Institucioni, ndërsa për 3 muaj tjerë të mbetur, pagesa e pagës prej 50% do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e që realizohet përmes MPMS.

Për realizimin e pagës përmes MPMS-së punëtorja duhet personalisht t'i drejtohet Entit për Punësim për realizimin e kësaj pagese.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen : Edona Bujupi Loxha, Menaxheri i Personelit dhe Përgjegjësjë për Paga, meditje dhe Kompensime dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe A nkesave në kuadër të Komunës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-28/018	Data: Datum: 29.01.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-4454 të datës 25.01.2018 e parashtruar nga Mejreme Llapaj nga Istogu, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj për kimioterapi në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit te nxjerri:

V E N D I M

1. MITATOHET: kërkesa Nr.06-553-4454 të datës 25.01.2018 e parashtruar nga Mejreme Llapaj dhe i lejohet furnizimi i automjetit me 180 litra karburant për tre muaj, për dërgimin e saj për kimioterapi në QKUK në Prishtinë.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë të lartpërmendurën me vërtetim për furnizim të automjetit me karburant në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburante të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Mejreme Llapaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-4454 të datës 25.01.2018, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin benët transportimi i Mejremes për kimioterapi në QKUK në Prishtinë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të lartpërmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Mejremja është e sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për kontrolle mjekësore në QKUK në Prishtinë.

Qendra Komunale e Mjekësisë Familjare në Istog nuk ka mundësi që të sigurojë transportin e saj. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomiko-sociale nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant. Shefi autoparkut do të pajisë të lartpërmendurën më vërtetim për furnizim me karburante nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Mejreme Llapaj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-29/018	Data: Datum: 29.01.2018	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 49. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi dhe mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-1995 të datës 11.01.2018 e parashtruar nga Vesel Zymeraj nga fsh. Serbobran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes Miana Zymberaj për kimioterapi në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-1995 të datës 11.01.2018 e parashtruar nga Vesel Zymeraj për përkrahje me karburant dhe i lejohet furnizimi i automjetit me karburant me 180 litra për tre muaj, për dërgimin e bashkëshortes Miana Zymeraj, për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë Vesel Zymeraj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Vesel Zymeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-1995 të datës 11.01.2018, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i Mianas për marrjen e kimioterapisë .

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Miana është e sëmurë dhe ka nevojë që të dërgohet për marrjen e kimioterapisë.

Të lartpërmendurit ka nevojë ti ndihmohet me karburant për dërgimin e bashkëshortes për marrjen e kimioterapisë, e që duke e pasur parasysh se gjendjen ekonomiko-sociale e ka të rend, nuk ka mundësi që t'i bartë të gjitha shpenzimet e transportit dhe është e arsyeshme që ti ndihmohet që të furnizohet me karburant.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i shëndetësisë, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do të kujdeset që të bëhet furnizimi me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u theksua u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim njoftohen: Vesel Zymeraj, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Shefi i autoparkut dhe një kopje në arkivin e Zyrës së Kryetarit.



Kryetari i Komunës
Haki RUGOVA